

TË FITOJMË LUFTËN E PASTËRTISË

Seminar me Dr. Xhim Ceci

PJESA E PARË “RIZGJIM I PASTËRTISË”

HYRJE

I. TRE URDHËRIME PËR PASTËRTINË SEKSUALE (1Thesalonikasve 4:3-6a)

“Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj...” (4:3a).

Urdhërimi #1 Hiqni dorë nga Imoraliteti Seksual

“... të hiqni dorë nga kurvëria. . .” (4:3b).

Urdhërimi #2 Mësoni si të Gjeneroni një Partner

“... që secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet në shenjtëri dhe me nder, jo me pasione epshi, si johebre që nuk e njohin Perëndinë. . .” (4:4-5).

Urdhërimi #3 Mos Mashtroni

“... dhe që askush të mos mashtrojë ose t'ia hedhë në punë vëllait të vet. . .” (4:6).

II. TRE ARSYE PSE TË RUAJMË PASTËRTINË SEKSUALE (1 Thesalonikasve 4:6b-8)

Arsyeja #1 Zoti Hakmerret ndaj Imoralitetit

“... sepse Perëndia është hakmarrësi për të gjitha këto gjëra, sikurse edhe ju thamë më parë dhe e dëshmuam.” (4:6b).

Arsyeja #2 Zoti u bën thirrje Besimtarëve të jenë të Pastër

“Sepse Perëndia nuk na thirri në ndyrësi, por në shenjtërim.” (4:7).

Arsyeja #3 Zoti Vetë është i Shenjtë dhe na Fuqizon ne për të qenë të Shenjtë

“Prandaj ai që i përbuz këto gjëra, nuk përbuz një njeri, por Perëndinë që ju dha edhe Frymën e tij të Shenjtë.” (4:8).

PJESA E DYTË

“TË QENIT NJË NË MARTESË”

I. KRIJIMI I ZOTIT PËR TËRHEQJEN SEKSUALE

1. Përcaktimi i Tij
2. Plani i Tij (Zan. 1:27; 2:24-25)
3. Vendimi Ynë (Ps. 139:13-14; 1 Tim. 4:4-5)

II. PLANI I ZOTIT PËR BASHKIMIN SEKSUAL (Marku 10:6-9)

1. Besëlidhja e Të qenit Një

- a) Martesa është një besëlidhje (Mal. 2:14)
- b) Martesa është një besëlidhje detyruese (Mk. 10:6-9)
- c) Martesa vulolet nga bashkimi seksual (Ez. 16:8)
- d) Martesa përfshin shprehjen rregullisht dhe vazhdimisht të dashurisë përmes bashkimit seksual (Zan. 2:18; 1 Kor. 7:5; Heb. 13:4)
- e) Besëlidhja e martesës mund të shkelet nga imoraliteti seksual (F. e U. 2:17; 1 Kor. 6:16; Ez. 16:59)

2. Unitet Përtëritës

- a) Besëlidhja shkatërrohet nga bashkimi seksual jashtë martesor (1 Kor. 6)
- b) Besëlidhja përtërihet përmes bashkimit seksual brenda martesës (Ez. 16:15, 59-60; Osea 2-3)

3. Ilustrimi i të qenit Një (Efes. 5:25-32)

4. Shenjtëria e të qenit Një (Zan. 2:24; LiP. 6:4; Zan. 4:1; FeU. 3:6)

5. Riprodhimi nga të qenit Një (Zan. 1:28; 4:1; 9:1, 7; Ps. 127:3-5)

6. Të qenit Një Fizikisht (Gen. 2:24-25; 1 Kor. 7:3-5)

7. Të qenit Një Emocionalisht (1 Pet. 3:8; Kantiku i Kantikëve)

8. Të qenit Një Shpirtërisht (1 Pet. 3:7; "vargjet për njëri-tjetrin")

9. Çlodhja nga të qenit Një (FeU. 5:15, 18-19; Kantiku i Kantikëve)

- a) Liria (1 Tim. 4:4-5)
- b) Kufizimet (Heb. 13:4; 1 Kor. 10:31; Efes. 5:25-32)

PJESA E TRETË “ABUZIMI I NJERIUT”

I. IMORALITETI

Përkufizimi: Imoraliteti është një mendim apo veprim që shkel planin e Zotit për seksualitetin tonë.

1. Mendime Plot Epsh

Përkufizimi: Çdo mendim që shkel planin e Zotit për seksualitetin tonë.

- a) Epshi makatar është një problem i zemrës.
- b) Epshi makatar është gjithashtu një reagim që mësohet.

2. Sjellja imorale

Përkufizimi: Sjellja imorale është çdo sjellje që shkel planin e Zotit për seksualitetin tonë.

Parimi i Prishjes

II. PANDJESHMËRI NDAJ SULMEVE TË MËKATIT: PROCESI I JOSHJES

Ne mashtrohemi nga:

1. Vetë mishi ynë – me prirjen e vet natyrale ndaj mëkatit.
2. Bota – dhe shtrembërimi i vlerave të saj.
3. Djalli – me planin e tij specifik për t'iu kundërvënë çdo gjëje të perëndishme.

Hapi #1 – Ngurues në kërkimin e Urtësisë Biblike

1. Meditoni çdo ditë mbi Fjalën e Zotit (Jozueu 1:8; Ps. 119:9-11; Ps. 1; 2 Timoteut 3:15-16)
2. Lutju Atij besnikërisht (Mat. 6:9-13; Gjoni 14:13-14; 1 Thesalonikasve 5:17; 1 Gjonit 5:14-15)
3. Mbajeni të rregullt pulsni tuaj shpirtëror

Hapi #2 - Dështim në Ndërtimin e Marrëdhënies Martesore

Hapi #3 - Fantazimi në Arenën e Mendjes

Hapi #4 – Flirtimi me persona të seksit të kundërt

1. Ne kullotim sytë (FeU 6:25)
2. Ndërtojmë një stil të pakujdesshëm jetese (FeU 7:7-8)
Natyra e Joshjes: Një Studim nga FeU 5-9
 1. Ajo e tërheq atë me sharmin e saj fizik (FeU.6:25; 7:10)
 2. Ajo e tërheq atë me personalitetin e saj (FeU.7:10-13; 9:13)
 3. Ajo e tërheq atë me fjalët e saj (FeU.6:24; 7:5, 14-15, 18-21; 2:16)
 4. Ajo e tërheq atë duke krijuar një atmosferë joshëse (FeU.7:11, 16-17)

Hapi #5 Rënia në Kurthin e Imoralitetit

Pasoja Specifike të Imoralitetit:

1. Ndjenjë faji dhe ndërgjegje e papastër (FeU 5:12-13)
2. Humbje nderi dhe turpërim publik (FeU 5:14; 6:33)
3. Humbje parash dhe varfëri e mundshme (FeU 5:10; 6:26)
4. Rënie në grackën e mëkatit të përhershëm (FeU 2:19; 5:22-23; 7:6-10; 23:27-28; Rom. 6:19; Heb. 3:13)
5. Sëmundje veneriane (FeU 5:7-11; Ps 38:1-8,11)
6. Plagë të shkaktuara nga një bashkëshort i zemëruar (FeU 6:33-35)
7. Vdekje fizike (FeU 5:9; 6:32; 1 Kor. 5:5; 11:30; 1 Gjonit 5:16)
8. Ndikim shpirtëror shkatërrues (FeU 7:27; 6:32)
9. Ndikime të tjera shoqërore (FeU 5:14; Ps. 38:11)

PJESA E KATËRT

“MBROJTJA E PASTËRTISË SIME PERSONALE”

HYRJE:

KUFIRI I MBROJTJES #1: RUAJTJA E MENDJES SIME

FeU 4:23 “Ruaje zemrën tënde me shumë kujdes, sepse nga ajo dalin burimet jetës.”

A. Mbroje atë

1. Përkufizimi: Mbrojtja e mendjes sime nga çdo gjë që shtrembëron të kuptuarin e planit të Zotit për seksualitetin tim.

Mark 7:21-23 “Sepse nga brenda, domethënë nga zemra e njeriut, dalin mendimet e mbrapshta, shkeljet e kurorës, kurvërimi, vrasjet...”

2. Diskutimi: Listoni plehrat që po ndotin jetën tënde (Bëj një listë në mendje apo të shkruar):

B. Përgatite atë

1. Përkufizimi: Duke ushqyer mendjen time me çfarë thotë Zoti për imoralitetin.

Ps 119:9-11. “Si mundet një i ri të bëjë rrugën e tij të pastër? Duke e ruajtur me fjalën tënde. Të kam kërkuar me gjithë zemër; mos më lër të devijoj nga urdhërimet e tua. E kam ruajtur fjalën tënde në zemrën time, që të mos mëkatoj kundër teje.”

2. Diskutimi: Shkruani dy vargje kyç në të cilët tregohet si ndihet Zoti në lidhje me imoralitetin.

C. Pastroje atë

1. Përkufizimi: Pastrimi i mendjes sime duke medituar mbi atë që thotë Zoti për Vetën dhe krijimin e Tij.

Rom. 12:2 “Dhe mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj, që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullnet i Perëndisë.

Fil. 4:8 “Së fundi, vëllezër, të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë të mirë, nëse ka ndonjë virtut dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni...”

2. Diskutimi: Listoni disa nga atributet e Zotit dhe si mund të ndikojë kjo e vërtetë në seksualitetin tim?

Psh: Zoti është i gjithë-dijshëm dhe prandaj ai i kupton luftërat e mia.

D. Përgatite atë

1. Përkufizimi: Vizualizo në mendjen tënde rezultatet shkatërruese të imoralitetit

2. Diskutimi: Nëse do të përfshihesha në veprime të imoralitetit seksual, do të prisja pasojat e mëposhtme:

(Jini specifikë. Përdorni emrat e gruas, fëmijëve, shokëve, etj. Shkruajini në fletë).

KUFIRI I MBROJTJES #2: RUAJTJA E TRUPIT TIM

A. Paraqite atë

1. Përkufizimi me dy pjesë:

Pjesa e parë: Ta paraqes veten tek Ai i cili ka të drejtën e pronësisë mbi trupin tim—Zoti.

1 Kor 6:12-20; Rom 6:11-14

Rom 12:1 “O vëllezër, po ju bëj thirrje, nëpërmjet dhembshurisë së Perëndisë, ta paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer te Perëndia, që është shërbesa juaj e mençur.”.

Pjesa e Dytë: Ta paraqes veten tek personi që ka të drejta tokësore mbi trupin tim—bashkëshorti/ja.

1 Kor 7:3-4

2. Diskutimi: Në lutje plotësoni më poshtë:

Unë, _____, paraqes të drejtën e pronësisë qiellore të trupit im tek Zoti im dhe të drejta tokësore mbi trupin tim për bashkëshortin/en tim/e.

B. Premtoje atë

1. Përkufizimi: Të bëj një marrëveshje besëlidhjeje me Zotin për çdo pjesë të trupit tim.

Jobi 31:1 “Unë kisha bërë një besëlidhje me sytë e mi; si mund ta fiksoja, pra, shikimin mbi një virgjëreshë?”

2. Diskutimi: Në lutje plotësoni më poshtë:

Unë, _____, bëj një marrëveshje besëlidhjeje me Zotin në lidhje me:

Sytë e mi të mos shohin _____ veshët e mi të mos dëgjojnë _____

goja ime të mos flasë për _____ duart e mia të mos prekin _____

këmbët e mia të mos nxitojnë drejt _____ mendja ime mos rrijë në _____

gjunjtë e mi të mos heqin dorë nga lutja për _____.

C. Mbroje atë

1. Përkufizimi: Mbroj trupin tim që të mos bjerë në imoralitet duke iu larguar së keqes.

- Shembulli i Jozefit tek Zanafilla 39
- II Tim 2:22. “Largohu nga pasionet rinore dhe bjeru pas drejtësisë...”
- FeU. 5:8 “...Mbaje larg prej saj rrugën tënde dhe mos iu afro portës së shtëpisë së saj.”
- FeU. 7:25. “Zemra jote të mos shkojë pas rrugëve të saj, mos devijojë nëpër shtigjet e saj.”
- I Thes. 5:22 “Hiqni dorë nga çdo dukje e ligë...”

2. Diskutimi: Çfarë situatash moralisht të rrezikshme ekzistojnë në ambientin ku jetoni dhe si mund t’i shmangni ato: në shtëpi, në punë, në komunitet, në kishë, ndërsa jeni në udhëtim? Listojini ato. Shkruani disa mënyra si mund t’i shmangni.

KUFIRI I MBROJTJES #3: RUAJ SHOKËT E MI

- 1 Kor. 12:14. “Sepse edhe trupi nuk është një gjymtyrë e vetme, por shumë. ...”
- Heb. 10:24. “Dhe le të kujdesemi për njeri tjetrin, për t’u nxitur për dashuri dhe vepra të mira...”
- FeU 27:17. “Hekuri mpreh hekurin, kështu njeriu mpreh fytyrën e shokut të tij. ...”

A. Lutu Për Ta

B. Mbroji Ata

- Grupe përgjegjshmërie.

" . . . Përlëvdoni Perëndinë, pra, në trupin tuaj " **1 Kor 6:20**